



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2145/ Prot

2

Shkodër, më 08.06.2026

Lënda: Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës për dy vende të lira pune.

Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof. dr. Tonin Gjuraq





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

R E K T O R I

Nr. 2145/Prot

Shkodër, më 08.06.2026

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune në fushen e Metodikës së Edukimit Muzikor, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Mësuesisë, në pozicionin "asistent-lektor/e" me kohë të plotë për vitin akademik 2026-2027, programi i studimit "Bachelor në Mësuesi për arsimin fillor dhe për arsimin parashkollor", për leksionet dhe seminarët e lëndëve "Edukim muzikor dhe metodologji", "Formim artistik muzikor dhe didaktikë".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushen e "Muzikës" në sistemin me kohë të plotë. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, e noterizuar.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor/Program studimi i nivelit të parë) në fushen e muzikës, duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë), kurse nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë). Kandidatët duhet ta kenë dhënë domosdoshmërisht provim lëndën për të cilën pretendojnë të jenë mësimdhënës ose lëndë të përafërta në grupin e lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet.
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i Arteve/Master i Arteve të Bukura/Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë, Program studimi 4-vjeçar) në fushen e muzikës duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
4. Nota mesatare e përgjithshme studimeve për diplomat e lëshuara në RSH, të cilat janë ekuivalente me diplomat Master i Shkencave, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas parimeve të procesit të Bolonjës, duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë), kurse nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë). Kandidatët duhet ta kenë dhënë domosdoshmërisht provim lëndën për të cilën pretendojnë të jenë mësimdhënës ose lëndë të përafërta në grupin e lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet.
5. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me nivel jo më të ulët se B2 (notë jo më të ulët se tetë), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
6. Preferohen kandidatët që :
 - 6/1. i përket kategorisë "Lektor" ose kanë përfunduar detyrimet e vitit të parë të shkollës doktores,
 - 6/2. gjatë niveleve të studimit, kanë dhënë provim lëndët "Solfezh", "Histori muzike", "Didaktikë (metodikë)"
 - 6/3. kanë përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë,
 - 6/4. kanë botime,

6/5. kanë aktivitete artistike.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor.
7. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë ku kërkojnë të punësohen si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar. •

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojnë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brëndshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, të noterizuara.
4. Kopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" dhe/ose titujve akademikë të fituar dhe/ose dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare. Për dëshmitë e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, të noterizuara.
5. Tre rekomandime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësve me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbarrimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë), certifikatë vaksinimi anti-Covid (nëse ka)
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore dhe/ose konflikt interesi).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letër-njoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar për kategorinë "Lektor" dhe me afat një-vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi për asistent-pedagogun dhe/ose "Doktorin e shkencave" që nuk ka së paku tre vite përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të gradës.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik. (me shënimin "Për konkursin e Departamentit të Mësuesisë")
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, testim me shkrim, intervistë dhe leksion të hapur brenda katër javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit etj. , i i drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

REKTORAT
Prof. dr. Tomë GJURAJ

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, , <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al